

KONTRATË SHITJE PASURIE E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot në datën 22.10.2022 palet e mëposhtme lidhin këtë kontratë shitje kotash në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe nenet 705 -756 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

Shitësi: Z. Erjon Sheku I biri I Hasan dhe Nadime lindur me 03.07.1989 shtetas shqiptar madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën rr Hodo Beg Nd 18 mbajtës i kartës së identitetit me nr ID I90703069G (ortak i vetëm i shoqërisë BEYOND MARKETING SHPK (këtu e në vijim do të quhet shitësi).

Blerësi: Jurgen Cala i biri i Fatmir dhe Xhemile lindur më 13.06.1994 shtetas shqiptar, me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën rr Ali Demi Pall 74 shk 3 ap32 mbajtës I kartës së identitetit me nr ID J40613055K (këtu e mëposhtë I quajtur Blerësi)

Shitësi dhe Blerësi referuar të dy sëbashku do të quhen palët

TË PËRGJITHSHME

1. Shitësi është zotërues i 100% (njëqind përqind) të kuotave në Shoqërinë BEYOND MARKETING Shpk (më poshtë e referuar si Shoqëria). Shoqëria është e regjistruar pranë QKB- së si shoqëri më përgjegjesi të kufizuar me NIPT M02108008I me seli ne adresen Rruga e Barrikadave, Zk.8220, Godina nr.48, H.14, Ap.12, Kati 4 Njesia Administrative Nr.9, dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj kryesore sherbime ne sektorin e telekomunikacionit etj.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë e përbërë nga 1 kuotë e vetme
3. Shitësi me vullnetin e tij të plotë, të lirë dhe të pavesuar dëshiron të shesë 100% të kuotave që ka në shoqëri blerësit, dhe blerësi dëshiron ti blejë sipas parashikimeve të kësaj kontrate.
4. Në përputhje me mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe nenet 705 -756 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë Dispozitat e Përgjithshme për shitjen”, hartohet kontrata e shitjes së kuotave si më poshtë vijon shitjen:



NENI 1

OBJEKTI

1. Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, shitësi i kalon nëpërmjet shitjes 100% të kuotave të shoqërisë dhe pjesëmarrjes në shoqëri si dhe të drejtën e pronësisë mbi kuotat dhe të gjithë të drejtat dhe detyrimet e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje blerësit, duke e garantuar plotësisht për titullin e pronësisë të pa rënduar me barrë dhe Blerësi nga ana tjetër merr nga shtiësi kuotat e tij në këtë shoqëri
2. Konkretisht Blerësi blen 100% të kuotave të kësaj shoqërie.

NENI 2

KALIMI I PRONËSISË SË LIGJSHME MBI KUOTAT

1. Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga shitësi tek blerësi do të bëhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe depozitimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 3


CMIMI DHE KALIMI I KUOTAVE

1. Kalimi 100% i kuotave bëhet me shitjen në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lek vlerë e barabartë me kapitalin e shoqërisë
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate ortak i vetëm i shoqërisë bëhet Blerësi Z. Jurgen Cala, në pjesëmarrje në % në shoqëri 100%, 1 kuotë dhe i cdo të drejtë dhe detyrimi që lind prej pronësisë dhe zoterimit të saj ndërsa Shitësi humbet cdo të drejtë dhe detyrim që lidhet me këtë kuotë,
3. Pagesa e mësipërme është kryer plotësisht nga Blerësi.

NENI 4

REGJISTRIMI

1. Regjistrimi i kalimit të kuotave nga Shitësi tek Blerësi në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.



NENI 5
GARANCITË

Shitësi në lidhje me kuotat garanton Blerësin :

1. Se është pronar i vetëm i kuotave të shitura dhe nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes për shitjen, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.
2. Të gjithë të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme në aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së kontratës së Shitjes së Kuotave janë pronë e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

NENI 6
LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo kontratë rregullohet nga Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare dhe nenet 705 -756 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë Dispozitat e Përgjithshme për shitjen”, Ligi Për Qendrën Komëtare të Biznesit: si dhe përkatësisht dispozitave të aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

NENI 7
ZGJIDHJA E MOSMARRESHJEVE

Plaët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim cdo mosmarreshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PALËT

SHITËSI

ERJON SHEKU

Erjon Sheku


BLERËSI

JURGEN CALA

Jurgen Cala
